



PROCESVERBAL

Mledhja e 07 e Rregullt e Asamblese Komunale është mbajtur me datë 30.09.2020 në ora 10:00 ne sallën e Asamblesë Komunale.

Mbledhja është udhehequr nga Kryesuesi i Kuvendit Z.Buyar Mazrek.
Në mledhje kanë marrë pjesë 13 anëtarë

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .

Të nderuar anëtar të Asamblesë, të nderuar misafirë mirë se erdhët në mbledhjen e 07të rregullt të Asamblese Komunale për vitin 2020. Mledhja është mbajtur në ora 10:00.

Rendi i dites:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i rregullores së tatimit ne pronë për vitin 2021
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit komunal për menaxhimin e mbeturinave
5. Shqyrtimi dhe miratimi i planit te buxhetit për vitet 2021-2023
6. Prezantimi i raportit të auditimit te mbrendshëm për vitin 2019
7. Prezantimi i raportit të auditimit të jashtëm për vitin 2019
8. Të ndryshme

1.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .

Të nderuar anëtarë , a ka dikush diçka me shtu në lidhje me procesverbal, nëse jo atëherë votojmë.

-Po

13

-Jo

0

-abstenim 0

Me vota unanime prosesverbali u pranua.

2.Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës;

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .

A ka dikush diçka me shtu në rend te ditës, nëse jo atëherë votojmë

Me vota unanime rendi i ditës u pranua .

3.Shqyrtimi dhe miratimi i rregullores së tatimit ne pronë për vitin 2021

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .

Sa i përket kësaj pike fjalën ia japim Drejtorit për Financa Z. Türker Mazrek.

Türker Mazrek.

Përshëndetje për të gjithë, rregullorja e tatimit në pronë si qdo vit edhe këtë vit njëherë duhet të votohet si draft mandej si rregullore. Ne muajin korrik kjo është votuar si draft dhe tani pa pësuar asnjë ndryshim po votohen si rregullore. Normat e tatimit veq po i shihni, sipas ligjit jemi munduar me i shfrytëzu normat më të ulëta të mundshme që janë, pra nën 16 % nuk mundemi me ul.. Në këtë rregullore nuk ka ndonjë ndryshim të madhë është e njëjta si qdo vit tjetër. Nëse keni diqka me pyt ose me shtu ndonjë propozim urdhëroni. Faleminderit

Buyar Mazrek:

A ka dikush diqka me shtu lidhur me këtë pikë, nëse jo atëherë votojmë.

Me vota unanime kjo pikë u votua.

4.Shqyrtimi dhe miratimi i Planit komunal per menaxhimin e mbeturinave

Buyar Mazrek:

Lidhur me këtë pikë fjalën ia japim zyrtarit i cili ka qenë anëtar i grupit punues Z. Haşim Morina.

Haşim Morina:

Përshëndetje për të gjithë. Para dy muajve në këtë plan e kemi miratuar si draft në kuvend dhe aty kanë qenë të gjitha sqarimet e duhura. Mbrenda kësaj kohe nuk ka pasur asnjë ndryshim ose propozim dhe nuk po e shoh të nevojshme që të jap sqarime sepse është e njëjta me draftin, veq nëse keni ndonjë pyetje mund të ju përgjigjem.

Ilyas Bayraktar:

Sa është vlere e projektit?

Haşim Morina:

Këtu nuk ka projekte, ky është vetëm një plan, pas miratimit të planit projektet do të dorëzohen në institucione të nevojshme.

Buyar Mazrek:

A ka dikush diqka me shtu lidhur me këtë pikë, nëse jo atëherë votojmë.

Me vota unanime kjo pikë u votua.

5.Shqyrtimi dhe miratimi i planit te buxhetit për vitet 2021-2023

Buyar Mazrek:

Sa i përket buxhetit fjalën ia japim Kryetarit të Komunës Z. Abdülhadi Krasniç:

Kryetarit i Komunës Z. Abdülhadi Krasniç:

Përshëndetje për të gjithë. Së pari ngushllime Semrës për humbjen e babait të saj, inshalla zoti e shpërblen me xhenet. Sa i përket buxhetit ndoshta edhe për shkak të pandemisë, sipas buxhetit që na ka ardhur nga Ministria e Financave në buxhetin për vitin 2021 në kategoritë mallra dhe shërbime, subvencione dhe transfere kemi mangësi të buxhetit. Në fakt ne si komunë problemin më të madhë e kemi tek projektet e investimeve kapitale. Në disa takime që i kemi zhvilluar me Ministrin e Financave e kemi diskutuar qështjen për rritjen e buxhetit në këto kategori dhe për komunat që kanë popullsi më pak se 20,000 banorë në vitin 2021 do të ndahet një buxhet shtesë deri 350,000-400,000€. Në takimet e komisioneve të grandeve ku anëtarë janë edhe kryetarët e komunave, deputetë, ministrat është marrë vendim që për

Komunat që kanë popullsi më pak se 20,000 banorë në vitin 2021 do të ndahet një buxhet shtesë deri 350,000-400,000€. Në buxhetin tonë aktual kemi projekte infastrukturore në vlerë 133,000€. Vitin e kaluar buxheti i arsimit ka qenë 200,000€ më pak. Në vitin 2021 kemi pasur një buxhet për investime kapitale në Drejtorinë e Arsimit kurse tani për mungesë të 48 nxënësve kemi reduktim të buxhetit në vlerë 200,000€. Buxheti jonë është 1,700,000€ por faktorët më negativë për ne është kufizimi i projekteve të infrastrukturës. Për vitin 2021 së bashku me mjetet që do të mblidhen nga të hyrat vetanake për projektin kanalizimi në Mamushë i kemi paraparë 56,934,00€, përveq kësaj këtë vit së bashku me Kforin turk dhe me mjetet që i kemi marrë nga Ministria jemi duke u munduar ti hapin rrugët fushore të Mamushës dhe me sa po shihet këto projekte nuk do të përfundohen me buxhetin e këtij viti dhe ne duke i ndarë 40,000€ për këtë projekt po mendojmë që ta përfundojmë që ta përfundojmë në vitin 2021. Përveq kësaj për projektin e asfaltimit dhe Rregullimit të rrugës Smaq kemi ndarë një buxhet prej 40,000€. Për pajisje bujqësore 45,000€ ikemi ndarë nga kapitalet dhe 25,500,00€ nga subvencionet pra në total 70,000,00€. Në fund për shëndetësi i kemi ndarë 8,000,00€ sepse po mendojmë që ndërtimi i objektit të QMF-së po shpresojmë që do të fillojë të ndërtohet këtë vit. Sipas njoftimeve që na kanë dhënë Misitria projekti është hartuar, është dorëzuar në institucionet përkaatëse dhe këtë javë do ta hapim tenderin. Sa i përket projektit të asfaltimit të rrugës smaq para dy jave me kërkesë të kryeministrit. Për shkak që në objektin egzistues të QMF-së nuk po mund të shtohet diqka më tepër ne e kemi parë të arsyeshme që të ndërtojmë një ndërtesë double dhe për këtë nuk duhen më shumë se 8.000€. Sai përket asfaltimit të rrugës Smaq para dy jave në drejtim të kërkesës së Kryeministrit nga Qeveria e Kosovës për Komunën e Mamushës janë ndarë 270.305.000€ dhe kemi diskutuar që me këtë buxhet që ta përfundojmë problemin e kanalizimit nga shkolla deri tek Lumi dhe për këtë i kemi ndarë 100.000.00€. Përveq kësaj për asfaltimin e rrugës për në Smaq i kemi ndarë 90.000.00€, aty përfshihen asfaltimi, skajoret dhe po mendojmë që këto mjete mjaftojnë për deri tek ura që nga asfalti deri tek ura po dalin 1.030 metra. Pasi që është i nevojshëm edhe grejderi ne kemi biseduar edhe me kforin turk dhe ata do të vijnë me grejder me drejtu rrugën. Për përfundimin e shtresë së parë të asfaltimit ne i kemi ndarë 90.000.00€ por për shtresën e dytë të asfaltimit ne si komunë i kemi ndarë 40.000.00 dhe për këtë gjatësi të rrugës kemi menduar që këto mjete mjaftojnë. Siq e thashë edhe më herët buxheti jonë është ky. Në kategorite mallra dhe shërbime dhe në subvencione dhe transfere nuk ka ndonjë ndryshim. Sa i përket subvencioneve shpresojmë që në kuadër të festivalit të bëhet tërheqja e mjeteve e dedikuara për bujqit e Mamushës sepse për shkak të pandemisë nuk do të ketë ndonjë aktivitet tjetër. Për shkak të pandemisë bujqit e Mamushës këtë vit nuk kanë mundur të ofrijnë në treg shumë produkte, nuk kanë mundur të shesin dhe të gjithë e dijmë që u kemi shumë borgj atyre. Edhe ndaj barnatoreve bujqësore të gjithë qytetarët kanë borgje sepse edhe ne po jetojmë në Mamushë dhe po i ndëgjojmë që po thojnë që po presim tua lëshojnë mjetete kompenzimit të dëmeve dhe të na paguajnë borgjet. Dje në takimin që e kemi mbajtur mr Ministrin e financave dy komuna dokumentet nuk i kanë pasur të kompletuara, ne si Ministri i kemi kompletuar dokumentet, i kemi dorëzuar në qeveri dhe nëse nuk i lëshojnë mjetet këtë javë, javën tjetër këto mjete do të jenë në llogari të bujqëve. Përveq kësaj Komuna e Mamushës e falendëron kabinetin e Ministrisë për shkak të angazhimit të komisionit nga ministria për verifikimin e vendgjarrjeve të dëmeve dhe pregaditjen e raporteve.

Buyar Mazrek:

Faleminderit Kryetar. A ka dikush diqka tjetër me shtu rreth buxhetit, urdhëro Z.Halim.

Halim SADIKU:

Përsëritet për të gjithë, sa i përket planit të buxhetit për vitet 2021-2023 unë po ndalna më shumë te projektet e investimeve kapitale ku po dihet buxheti për 2021 është buxhet i limituar, për investime kapitale janë 190.000.00€ ku as këto nuk janë të sigurta nëse nuk mblidhen mjetet nga të hyrat vetanake. Unë e kam cek edhe tek komisioni për komunitete edhe prap kam me cek sepse kam pakjartësi, përshembull është zyra e Kryetarit numri i stafit është 10 kurse paga dhe mëditje janë 58.650.00€, shuma totale është 98.650.00€, unë po tham pse mos mu nda pagat veq, mëditjet veq. Shërbimet tjera shembull si darka, dreka, nafti, qdo sen mu cek detaj. Unë gjithmonë e kum pas problem edhe në këtë mandat edhe para këtij mandati. Qka ju kushton shembull në qoftëse na kërkojnë fatura prej X Y institucioneve për dreka ose darka të komunës,

raportet janë ama nuk ka asnjë detaj. Herav tjera bjerni raport më të detajuar, paga dihet për 10 persona sa janë, mëditjet mu nda veq, derivatet mu nda veq, darkat edhe drekat mu nda veq, domethënë këtë e kam kërkuar gjithmonë. Po të jetë qekjo transparencë binduni që unë nuk do të jem këtu. Shkojmë tek investimet kapitale, ktu e kemi kanalizimi në Mamushë, let ceket njëherë e përgjithmonë ku është kanalizimi në mamushë, sa metra i ka pra projekti le të jetë i detajum, me gjithëse e kum lyp edhe me dokument, sa metra, qfarë gypi, emri i rrugës, cili kanalizim është se tash përshembull na pe votojmë këtë plan por po të jetë një ndërkombëtar këtu me neve ka me kesh. Nëse kërkon me analizu se qka kemi votu ndoshta mundona me qenë i qartë por prap kam me pas paqartësi për shkak se nuk ka projekte të detajume, plus asaj para se mu bo kjo a keni mbajt debat me qytetarë, qka dhe cili është prioriteti i qytetarëve, aq ven i vogël jemi sa që na mujm me bo gjithq mirë, mos me na ikë asnjë detaj. Në qendër të Mamushës mundemi me mbajtë takim dhe me i ftu të gjithë qytetarët dhe me i tregu që buxheti për investimet kapitale është 190.000.00€, na e kena planifiku si komune qeto qeto me bo, qka po jav merr menja qytetarë të nderum? Transparenca po na mungon. Shpresoj dhe besoj që në të ardhmen do të jemi më të qartë. Faleminderit.

Buyar Mazrek:

Faleminderit Halim. Urdhëro Kryetar.

Kryetarit i Komunës Z. Abdülhadi Krasniç:

Halim na po e vendosimin kanalizimin sepse e dimë që po kemi problem me të. Nëse e kishim pasur ne buxhetin e komunës së Prizrenit ose të Prishtinës që i kanë për investime kapitale 1 milion, 2 milion ose 5 milion. Shembull kanalizimi Mamushë –Medvec është 1.5km, gjerësia, gjatësia dhe gypat që do të vendosen në këtë kanalizim po kushtojnë 300.000.00€ kurse ne totalin e kapitaleve e kemi 100.000.00€, për këtë arsye ne po e zgjedhim këtë opcion, ndoshta edhe gabim e kemi, asnjëherë nuk tham që 100% kemi të drejtë patjetër që ka edhe gabime. Ne kur i kemi bërë kërkesë Ministrisë për kanalizim i kemi treguar që vlera e projektit është 400.000.00€ dhe ne si komunë mundemi me kontribu vetëm 10% kurse ju mbuloni 360.000.00€, fundja nëse nuk mundemi me i siguru të gjitha mjetet atëherë vendosim kanalizim në vlerë prej 40.000.00€. Sa i përket planifikimt për darka, dreka, naftë etj të gjitha janë bërë por nëse ju kujtohet më herët kemi pasur një buxhet me pesë shifra ku Ministri i Financave thoshte që darkave zyrtare do tia ndan 500 €, naftit 5000€, udhëtimit zyrtar 1000€. Tani si komunë e Mamushës shpenzimet e naftit për kforin turk po i mbulojmë ne dhe tani komunës së Mamushës për një muaj shpenzimet e naftit kanë me i dalë deri 1000€/ . Viteve tjera duhet ta klemi parasysh që duhet me cek që shpenzimet e naftit për punët që po i kryejnë kfori turk janë kaq, pra varet nga puna që e realizojnë. Por së fundi po kryejnë punë dhe duhet me falendëru Kforin turk sepse po i shërbejnë Mamushës, qytetarëve të Mamushës, kjo komunë është për qytetarët e Mamushë dhe do të mundohemi maksimalisht që ti mbulojmë kërkesat e tyre. Komuna e Mamushës asnjëherë nuk e ka bërë auditimn e mbrendshëm por këtë vit Ministria e ka bërë plus e kemi edhe raportin e auditimit të jashtëm të cilat do të prezantohen në pikat në vijim. Por komuna e Mamushës më së shumti ka marrë vërejtje tek menaxhimi i pasurisë por për mua më e rëndësishme është që asnjëherë nuk kemi marrë vërejtje në prokurim, as në këtë mandat as në mandatin e kaluar. Kjo është sa i përket buxhetit, kanalizimin qëllimisht po e lëmë hapur për me pas mundësi me marrë mjete prej nga mundemi por ishalla kemi fatin që Komunës të na lëshojnë 400.000.00€ për projekte infrastrukture dhe në së bashku me anëtarët e kuvendit i shohim projektet më prioritare të Mamushës dhe mundohemi ti realizojmë ato. Sa i përket takimeve me qytetarë komuna e Mamushës sipas ligjit i ka përfunduar mbledhjet edhe drejtori është këtu, nënkryetarët kanë marrë pjesë. Faleminderit.

Buyar Mazrek:

Faleminderit Kryetar. A ka dikush diqka tjetër me shtu rreth buxhetit, urdhëro Z.Halim.

Halim Sadiku :

Ë nderuar kryetar unë nuk kam qef kërkush kërkam me akuzu por unë po kërktoj më të mirën të mundshmë me e bo për komunën e Mamushës, për këta qytetarë të mrekullueshëm, domethënë kjo po lypet sepse ka ankesa prej qytetarëve shumë por e dijmë edhe buxhetin sa e kemi por me këtë buxhet që e kemi me ia ofru qytetarit më të mirën të mundshmen. Sa i përket pastërtisë pas shumë kritikave po e shoh që keni fillu me pastru Mamushën por kishte qenë mirë që edhe lumenjtë të pastrohen, mi pre drunjët përkaj lumenjëve për shkak se po mbledhen edhe lumin pe qesin prej shtratit. Por edhe ni vrejte e kam, pse drejtorat me hezitu mos me ardhë në mledhje, ai ka me msu diqka prej meje, nëse e ndëgjojnë zërin tim, të Qamilit e të tjerëve kanë me e kuptu më tepër nevojën e qytetarit, puna në bashkësi ka me qenë më efektive. Nëse ata nuk janë në mledhje nuk kanë me qenë asnjëherë në ngjarje, qka do me dit ai me punu, shembull a keni ni që drunjët dy herë e kanë qit prej shtratit lumin, pse mos mi marrë mi pre këta drunjë, ata që kanë nevojë me ia dhënë sepse traktorin e kemi edhe ua dërgon familjeve në nevojë. Qështu tu u msu njoni pi tjetrit edhe punët shkojnë më mirë, më mbarë. Faleminderit.

Buyar Mazrek:

Faleminderit Halim. A ka dikush diqka tjetër me shtu rreth buxhetit, urdhëro Z.Ilyas Bayraktar

Ilyas Bayraktar:

Unë shprehi ngushëllimet e mija për vdekjen e babait të anëtarës së kuvendit, zoti e shpërbletë me xhenet. Kryetari i komunës tha që komuna e Prizrenit ka buxhet të madhë por buxhet i madhë do të thotë investim i madhë në një territor të madhë. Ne jemi një territor i vogël dhe nëse kemi mundësi që qdo vit të ndajmë një shumë të caktuar të mjeteve dhe ta kryejmë qështjen e kanalizimit, ndoshta kemi edhe fatin dhe na ofrohen 400.000.00€ edhe e përfundojmë kanalizimin menjëherë por edhe pjesë pjesë mundemi me e përfundu. Sa i përket planit të buxhetit të viteve 2021-2023 ka mangësi por me këtë buxhet që e kemi mundemi me vepru, duhet me i zgjatë këmbët sa e kemi jorganin. Kështu që kur të pregaditet buxheti herav tjera të kenë kujdes më tepër. Faleminderit.

Buyar Mazrek:

Faleminderit Ilyas urdhëro Halim.

Halim Sadiku :

Në qoftëse ban, vetëm edhe një falendërim e ka kryetari i komunës prej mbi 40 familjeve që kum pas kontakt unë, na i kemi mledh mjetet për me e qu rrymen prej trafos e deri te ura, kryetari komunës kryetari i komunës me ndihmën e KEDS-it ka marr përsipër me in, thuajse gati e ka përfundu projektin, e ka një falenderim qëmbi 40 familjeve kanë me ju kthy mjetet mrapa. Faleminderit.

Kryetari i Komunës Z. Abdülhadi Krasniç:

Unë dua ti falendëroj të gjithë anëtarët e kuvendit sepse të gjithë më keni përkrahur për blerjen e trafos së re dhe shtyllave elektrike por ne takimin që e kemi mbajtur me Kedsin madhësia e projektit që e kemi kërkuar ne së bashku me juve ka qenë 35.000€-40.000 € dhe ne si komunë nuk kemi me pagu asnjë cent për me i vendos ato shtyllat elektrike por na nuk do të hapim tender për blerjen e trafos sepse veq trafoja po kushton 15.000€ deri 20.000€, ne do ta presim marrëveshjen e mirëkuptimit me KEDS-in dhe me miratimin e kuvendit do ti thojmë Kedsit që ne si komunë mundemi me kontribu kaq ndërsa pjesën tjetër kompletojeni ju. Edhe njëheër edhe unë desha ti falendëroj këto familje, gjithashtu me ndihmën e kforin turk dhe me nperkrahjen e qeverisë së Kosovës kemi arritur që ti hapim shumë rrugë. Faleminderit.

Halim Sadiku

I nderuar kryesues, me projektin e fundit që e kanë bërë ata mbi 50 familje mo as një motorr të ujit nuk kanë me u aktivizu, të gjitha këto familje, këta pronarë të tokave kanë me ujit me sistemin e ujitjes, automatikisht me rrymë. Ky është një rezultat shumë i mirë. Faleminderit.

Buyar Mazrek:

Faleminderit Halim urdhëro Ilyas.

Ilyas Bayraktar:

Ë nderuar Kryetar na që i kemi ndarë mjetet për trafo elektrike për kabllot, për shtylla, a i keni dërgu në ndonjë projekt tjetër. Desha me falendëru edhe Kforin Turk për përkrahjen që po na bënë por faturat e shpenzimeve të karburanteve që po bëhen për Kfor mbani veq që mos të figurojnë si shpenzime të mëdha të komunës.

Kryetarit i Komunës Z. Abdülhadi Krasniç:

Po po ndamas do të jenë faturat veq se do të figurojë që komuna e mamushës ka shpenzuar më tepër karburant.

Ilyas Bayraktar:

Po mundet me dalë ma tepër por kur të mbahen faturat ndamas del dihet që kanë punuar dhe ky shpenzim është bërë për ta. Faleminderit.

Buyar Mazrek:

Faleminderit Ilyas. A ka dikush diqka tjetër me shtu rreth kësaj pike, nëse jo atëherë votojmë.

Me vota unanime plani i buxhetit u miratua.

6. Prezantimi i raportit të auditimit të mbrendshëm për vitin 2019

Buyar Mazrek:

Sa i përket raportit të auditimit fjalën ia japim Znj. Xhevahire Rushiti

Xhevahire Rushiti:

Ju përshendes të gjithëve, si obligim ligjor e kemi për detyrë me ju prezentu raportin e mbrendshëm dhe të jashtëm të auditimit. Ne si komunë nuk kemi auditorë të mbrendshëm dhe i kemi kërku Ministrisë së Financave ata me kry auditimin e mbrendshëm për ne. Janë disa të gjetura që ata i kanë gjetur, kryetari veq e tha që kemi mangësi por unë veq e kujtoj në vitin 2008 na jemi kon 1 e sivjet kemi mrrë në 5 minus domethënë ka përmirësimë, ka rekomandime që kanë mundësi mu përmirësu. Prokurimi ka dalë mirë, financat kanë dalë tepër mirë.

Buyar Mazrek:

A ka dikush diqka me shtu në këtë pikë, nëse jo kalojmë në pikën tjetër.

7. Prezantimi i raportit të auditimit të jashtëm për vitin 2019

Buyar Mazrek:

Xhevahire Rushiti:

Te raporti i audimit të jashtëm është fushë më e gjërë, përpara vishin 1 herë në vit kurse tash po vijnë 3 herë në vit edhe mirë po bëjnë që po vijnë se edhe na po msohem prej gabimeve tona. Kryetari e prezentoj që njëra prej pikave kyçe që është prokurimi ka dalë shumë mirë, prezantimi i buxhetit ka dalë shumë mirë, janë do rekomandime që te bogazet e ka theksu. Janë do rekomandime që na japin vjet përvjet edhe qe na duhet me përmirësu, shembull na këto paret e qertifikatave, Mamusha nuk është vend ku psh Fetahi i then 100€ për 1 €, jemi mundu përshembull qdo dy tre dit mi dorëzu, këto janë ato të gjeturat. Nëse ka dikush diqka me pyt urdhëroni.

Ilyas Bayraktar:

Kur e shikojmë raportin shohim disa mangësi por kjo në fakt për ne është shumë mirë sepse na po mësojmë prej gabimeve tona por më e rëndësishmja është depozitimi i vonuar i parasë në bankë, këto mjete shembull nëse nuk keni mundur me i depozitu në baza ditore atëherë këni pasur mundësi me i depozitu në baza javore e jo pas 57 dite. E dyta, kryetari i komunës gjatë transferimit të mjeteve nga një projekt në projekt tjetër duhet të mirret miratimi nga kuvendi, në shumë raste na kanë paralajmëruar. Depozitimi i vonuar i parasë në bankë , fuqizimi i kontroleve të mbrendshme të komunës, pra nëse e shohim mirë ata na kanë paralajmëruar për disa qështje. Mandej mangësi në rekrutim, këtu nuk iu kanë përshtatur rregullave sa duhet, ndoshta edhe kryetari vet e ka lexuar këtë. Tek blerja e aseteve ka mangësi veqanërisht tek Drjtoria e Mahmutit ka vërejtje, dobësi në regjistrimin dhe inventarizimin e pasurisë, shpresoj që këto gabime më nuk përsëriten.

Xhevahire Rushiti:

Edhe unë thash që ka mangësi, ka nevojë për përmirësime po ishalla kadal kadale edhe na msohemi.

Ilyas Bayraktar:

Shembull tek keq klasifikimi i shpenzimeve janë 150.341€

Xhevahire Rushiti:

150 .000€ janë Na që e kemi projektin për bashkëfinancim që i pagujnë ndrrimin e natës, këta që fshijnë, aty thotë auditori qet projekt duhet me pas prej mallrav dhe shërbimet, domethënë në 2020 e kemi hek qeto. Edhe tjetra është te pajisjet bujqësore, na i kemi në dy pjesë të ndame pajisjet bujqësore, një pjesë e pagujmë prej kapitaleve, një pjesë e pagujmë prej subvencioneve edhe aty thotë edhe pse komuna ka bërë përpjekje por klasifikimi ekonomik është gabim, atë e kemi pranë edhe na. Edhe ni keq klasifikim e ka aty që i kemi pagu jubilarët për mësimdhënës se sdi a e dini që msusët janë tu i akuzu krejt komunat e Kosovës për shujta, rrugë. Shembull dy msusa kanë dalë sivjet në pension unë kum kërku prej ministrisë së financave me i pagu pensionet prej rrogave por ministria e Financave ka thënë viti i pandemisë, realizojë vetë domethënë unë e kam me dëshmi atë. Për mos me pru te gjykata i kemi pagu nga mallrat dhe shërbimet.

Ilyas Bayraktar:

Realizimi i punimeve në prona private. Investimet e parasë publike në pronat private nuk rezultojnë me përfitimin publik në interes të qytetarëve. Ky investim i ekspozohet rrezikut të dëmtimit apo edhe të ndalimit për shfrytëzim, ngaqë nuk ka ndonjë pëlqim formal paraprak për lejimin e realizimit të projektit nga ana e pronareve të këtyre tokave.

Xhevahire Rushiti:

İlyaz e kemi diskutu edhe me auditor këtë pikë, ju kum spjegu që Mamusha nuk është Prizren ose Malisheve.

Ilyas Bayraktar:

Nuk keni raport per blerje të pasurisë, pra në shumë qështje ka mangësi.

Xhevahire Rushiti:

Pasurinë jemi tu e regjistru komplet, deri në fund të 2020 kemi me bërë regjistrimin dhe envantirizimin total të pasurisë. Faleminderit.

Buyar Mazrek: (Kryesues i Kuvendit)

A ka dikush diqka tjetër me shtu nëse jo kalojmë në të ndryshmet.

8.Të ndryshme.

Buyar Mazrek: (Kryesues i Kuvendit)

A ka dikush diqka me shtu në të ndryshmet, urdhëro Aysel.

Aysel Mazrek:

Përshëndetje për të gjithë, kam një pyetje për juve Z. Kryetar, kush e mirëmban faqen e facebookit të Mamushës.

Kryetarit i Komunës Z. Abdülhadi Krasniç:

Ne e përdorim.

Aysel Mazrek:

Si person kush e përdor?

Kryetarit i Komunës Z. Abdülhadi Krasniç:

Unë, Turkeri edhe Ruzhdia.

Aysel Mazrek:

Më herët ka ardhur Znj. Myfera në shkollë, janë nxjerrë foto, vetëm fotoja ime me vajzën e vllaut ka qëndruar dy orë apas dy ore është hequr, mandej e kum kuptu që Turkeri edhe Ruzhdia po e përdorë fb-në, unë i kam shkruar atyre por nuk më kanë kthyer përgjigje. E kam edhe një pyetje, cila është detyra e policëve tanë në Mamushë, qka do që ndodhë në Mamushë ju jeni të njoftuar, a kanë të njoftim policia për përmbauesit të cilët e kanë bastisur shtëpinë e babit tim? Unë kam dërguar ankesë tek policia por nuk e kanë pranuar.

Kryetarit i Komunës Z. Abdülhadi Krasniç:

Unë nuk mundem me ditë punën e tyre edhe smundem me ju përzi në detyrat e tyre.

Aysel Mazrek:

Unë ju tregova juve këtu se si është situata.

Buyar Mazrek: (Kryesues i Kuvendit)

A ka dikush diqka me shtu në të ndryshmet, urdhëro Ilyas.

Ilyas Bayraktar:

Në një ngjarje që ka ndodhur në Mamushë nëse policia ka marrë vendim atëherë policia e zbaton atë vendim, kryetari i komunës ose ne nuk mundemi me ndërhy asgjë. Këtë mundesh me e zgjidhë përmes avokatit, i hap padi palës së kundërt.

Aysel Mazrek

Unë po du vetëm me ditë që përmbaruesit para se me ardhë ne Mamushë me bastisë dikë a nuk e lajmërojnë policinë, apo me paralajmëru. Qysh shkon përmbaruesi e bastisë shtëpinë kur aty ka gra, ka fëmijë.

Buyar Mazrek: (Kryesues i Kuvendit)

A ka dikush diqka me shtu në të ndryshmet, urdhëro Halim .

Halim Sadiku:

Ju përshëndes të gjithëve. Na e kan problemin me rrugë, kanalizim, ndriqim, pastërti, nuk e kena na problemin individual, unë e kam ni borgj edhe përmbaruesi mka ardhë mu, ajo është qështje e përmbaruesit, qështje e policisë. Përmbaruesi është i votun në parlament të Kosovës, ai ka autorizim me ta konfisku pasurinë. Kështu që Z. Kryetar jemi tu hi në sezonë të dimrit dhe ki punë bajagi shumë me lumenjë, të kisha rekomandu hini kapak lumenjve sa është uji ma i cekët, hini pak pastroji, i ki gjashtë veta, traktorin e ki të fortë, degët, dru, të paktën bile një 10% ka me i ndihmu familjeve në nevojë. Une edhe në mbledhjen paraprake e ceka, një punëtor e ka fshati Leshan edhe as ni mbeturinë nuk mundesh me e gjetë në rrugë.

Buyar Mazrek: (Kryesues i Kuvendit)

A ka dikush diqka me shtu në të ndryshmet, urdhëro Ilyas .

Ilyas Bayraktar:

Halimi ka pak të drejtë, ne jemi të pakujdesshëm rreth hudhjes së mbeturinave , i hudhim kudo por nëse e shikojmë nga aspekti i pastërtisë Mamusha ka ngecur shumë mrapa. Qytetari shkon deri tek shporta e mbeturinave dhe qëllimisht e hudh mbeturinën në tokë.

Nehat TAÇ:

Qysh me marrë me pastru lumin dhe druri që është aty është i imi, qysh ka drejtë ai me ma marrë lisin tim, me pa ni puntorë të komunës me ma marrë lisin aty , se lejoj.

Türker Mazrek:

Sa i përket pytjes se kush e përdor faqen e Fb të komunës po ju tregoj që ne e përdorim por atë ditë një foto e tillë nuk është nxjerrë fare, nga 75 fotografi që më kanë ardhur mua në asnjë foto nuk ka qenë ajo foto as në aparatit fotografik. E para na nuk e kemi bërë këtë foto fare, e dyta, nëse nuk na beson mundesh mundesh me hi tek cilësimet e faqes së Fb, aty mundesh me gjetë a ka qenë ajo foto a jo?

Ilyas Bayraktar:

Sikur na nuk kemi punë tjera veq me kqyr a ka dalë apo nuk ka dalë në foto Zonja Myfera, kjo nuk i interson fare komunës. I nderuar kryetar është shumë gabim me dhënë emra se kush e përdor faqën e komunës në Facebook, mundesh me thënë është dikush që e përdor, mundet me qenë gabim, e jo me cek emra.

Buyar Mazrek: (Kryesues i Kuvendit)

Të nderuar anëtarë nëse nuk keni diqka me shtu në të ndryshmet atëherë mledhja ka përfunduar. Faleminderit për pjesmarrje.

Proces mbajtësi
Idriz Mazrek

Kryesuesi i Kuvendit
Buyar Mazrek